Qeveria mund t'i përcaktojë kufizimet gjatë kryerjes së tregtisë në rastet nga paragrafi 1 të këtij neni vetëm në rast se çrregullimi nuk mund të mënjanohet me masa tjera apo nëse nevojat nuk mund të mbulohen nga rezervat e mallrave, me import ose me masa tjera të politikës tregtare.

Neni 30

Në rastet nga neni 29 paragrafi 1 të këtij Ligji, Qeveria mund t'i përcaktojë këto masa:

- kufizimi i tregtis[me mallra të caktuara ose kushte të veçanta për tregtin[me mallra të caktuara;

- caktimi i çmimeve më të larta për disa prodhime dhe shërbime në prodhim dhe qarkullim;

- kufizimi i eksportit apo importit të mallrave të caktuar ose përcaktimin e kushteve të veçanta për import ose eksport të mallrave të caktuar;

- ndalimi për tregtarët të kryejnë tregti me mallra të caktuar;

- obligimi i tregtarëve të sigurojnë dhe shesin lloje të caktuara të mallrave dhe sasi të mallrave të caktuar, t'u shesin mallra konsumatorëve të caktuar sipas radhitjes së përcaktuar;

- obligimi për disa tregtarë që të ruajnë lloje dhe sasi të caktuara të mallrave;

- ndalimi i përdorimit të mallrave të caktuar për prodhimin e mallrave të tjerë.

Tregtari është i obliguar t'u përmbahet masave nga paragrafi 1 i këtij neni.

IV. KUSHTET PËR KRYERJEN E TREGTISË ME VENDET E JASHTME

Neni 31

Tregtia me vendet e jashtme kryhet lirshëm në pajtim me ligjin, dispozitat e miratuara në bazë të ligjit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare dhe marrëveshjeve që i ka ratifikuar Republika e Maqedonisë.

Kushtet të cilat patjetër duhet t'i plotësojnë mallrat gjatë importit

Neni 32

Tregtari është i obliguar që gjatë importit të mallrave, organeve kompetente inspektuese para procedurës së doganimit t'iu dorëzojë dëshmi se:

- mallrat janë të formuara me kërkesa të caktuara teknike, janë shënuar në mënyrë përkatëse dhe përcillen me dokumente të përcaktuara në dispozitat teknike, në pajtim me ligjin për caktimin e kërkesave teknike për prodhimet dhe vlerësimin e përputhshmërisë;

- janë përmbushur kushtet e caktuara për cilësinë e mallrave;

- mallrat kanë deklaratë përkatëse dhe udhëzim për përdorim të shkruara në gjuhën maqedonase me alfabetin cirilik në ambalazhin origjinal, gjë që nuk e përjashton mundësinë për përdorim të njëkohshëm të gjuhëve dhe shenjave të tjera, të kuptueshme lehtë për blerësit;

- mallrat i përmbushin kushtet e përcaktuara për cilësinë e prodhimeve sa i përket cilësive fizike-kimike dhe organike, sasisë, paketimit si dhe kushteve për transportin e mallit, sa i përket mjetit transportues dhe mënyrës së transportimit në pajtim me ligjin.

Neni 33

Mallrat, për të cilat me ligj janë përcaktuar kushte të veçanta për kryerjen e tregtisë në vend, mund të importohen vetëm nëse importuesi para filialave kompetente të Drejtorisë Doganore paraqet dëshmi për përmbushjen e kushteve të veçanta, lëshuar nga organi kompetent, i përcaktuar me ligj.

Leje për eksportin dhe importin e mallrave

Neni 34

Eksporti dhe importi për mallra të caktuar mund të bëhet në bazë të lejes dhe atë për:

- mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së njerëzve;
- mbrojtjen e moralit publik;
- mbrojtjen e bimëve, kafshëve, materialit për farë, si dhe prodhimeve të tjera bujqësore;
- mbrojtjen e ambientit jetësor dhe planifikimit hapësinor;
- mallrat që eksportohen dhe importohen për nevojat e shërbimit të veterinarisë;
- mallrat, të cilët duhet t'i përmbushin kushtet e caktuara meteorologjike dhe kushtet tjera;
- importin e prodhimeve të gatshme dhe prodhimeve të papërdorura, e për të cilat nevojitet vërtetimi për kontrollin e bërë dhe evidentimin e dokumentacionit teknik përcjellës të prodhimit nga Instituti për Standardizim;
- mallrat, për transportin dhe importin e të cilave nevojitet leja nga Banka Popullore e Maqedonisë;
- eksportin dhe importin e veprave historike dhe artistike;
- eksportin dhe importin e disa metaleve fisnike, kartmonedhave etj.;
- mjetet për armatim dhe pajisje ushtarake, të destinuara për nevojat e sigurimit të sigurisë publike dhe mbrojtjes dhe mallrat e tjera.

Mallrat që eksportohen dhe importohen në bazë të lejes lëshuar nga organi kompetent, do t'i përcaktojë Qeveria me propozim të Ministrisë së Ekonomisë.

Lejen për eksportin dhe importin e mjeteve për armatim dhe pajisjeve ushtarake e lëshon Ministria e Mbrojtjes, përkatësisht Minisatria e Punëve të Brendshme.

V. MASA MBROJTËSE

Komisioni për masa mbrojtëse gjatë importit të rritur dhe të subvencionuar

Neni 35

Për zbatimin e masave për mbrojtjen e prodhimtarisë së vendit nga importi i rritur dhe i subvencionuar, Qeveria formon Komision për masa mbrojtëse gjatë importit të rritur dhe të subvencionuar (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni).

Komisionin nga paragrafi 1 të këtij neni e emron Qeveria me propozim të Ministrisë së Ekonomisë.

Me Komisionin udhëheq ministri i Ekonomisë.

Qeveria përcakton mënyrën dhe procedurën për punën e Komisionit.

Punë administrative-teknike dhe profesioniste për nevojat e Komisionit i kryen shërbimi profesional i Ministrisë së Ekonomisë.

Masa për mbrojtjen e industrisë së vendit nga importi i rritur

Neni 36

Nëse në një periudhë të shkurtër kohore rritet importi i një malli të caktuar, absolutisht apo relativisht në raport me prodhimin e vendit, dhe nëse me këtë rritje të importit i shkaktohet dëm apo pason rreziku nga shkaktimi i dëmit serioz për industrinë e vendit, e cila prodhon prodhime të njëjta ose të ngjashme konkurrense, Qeveria me propozim të Komisionit do të ndërmarrë masa mbrojtëse adekuate (në tekstin e mëtejshëm: masa), me qëllim që të shmangen dëmet dhe rregullimet e krijuara nga ky import.

Me "dëm serioz" sipas paragrafit 1 të këtij neni llogaritet keqsimi i gjendjes të prodhuesit të prodhimtarin e vendit, ndërsa me "rrezik nga dëm serioz" konsiderohet dëm serioz për të cilin shtet e qartë se shtet i pashmangshëm.

Me "industri të vendit" sipas paragrafit 1 të këtij neni do të konsiderohen të gjithë prodhuesit të cilët prodhojnë prodhime të njëjta ose të ngjashme në territorin e Republikës së Maqedonisë, si dhe ato, prodhimi i përfaqësohet i të cilëve, në prodhime të njëjta ose të ngjashme e përfaqësohen pjesën më të madhe të prodhimit të prodhuesve të vendit të atyre prodhimeve.

Procedura paraprake e Komisionit

Neni 37

Masat nga neni 36 paragrafi 1 i këtij ligji do të zbatohen mbi të gjitha mallrat që importohen pavarësisht nga vendi i prejardhjes ose vendi i importit.

Masat nga neni 36 paragrafi 1 i këtij ligji mund të ndërmirren vetëm nëse në procedurën e ngritur nga Komisioni dëshmohet arsyeja për importin e rritur të ndonjë malli dhe dëmin serioz, përkatësisht mundësia për krijimin e dëmit serioz për industrinë e vendit.

Nëse në procedurën e ngritur nga paragrafi 2 i këtij neni konstatohet se dëm serioz nga industrinë e vendit, shtet krijuar nga arsye të tjera, e jo nga importi i rritur i ndonjë malli të caktuar i realizuar në periudhën e njëjtë, nuk mund të zbatohen masat nga neni 36 paragrafi 1 i këtij ligji.

Komisioni në procedurën nga paragrafi 2 i këtij neni i vlerëson të gjitha faktet dhe dëshmimet, dhe veprimet e gjendjes në veprimtaritë e caktuara prodhuese, rritjen e prodhuesve të importit të mallit të caktuar në sasi absolute dhe relative, gjendjen në tregun e vendit të krijuar për shkak të importit të rritur, shfrytëzimin e kapaciteteve prodhuese, gjendjen e fitimit ose të humbjes, ndikimin në importin e rritur në punësimin në veprimtari të caktuara prodhuese dhe rrethanat të tjera me të cilat pjesë e prodhimit të prodhimin e vendit të kësaj mallrave.

Gjatë procedurës Komisioni do t'i ftojë të gjitha palët e interesuara (eksportues, importues etj.) për debat publik, për të paraqitur qëndrimet e tyre dhe t'u bën me dije për nevojën e marrjes së masave mbrojtëse.

Komisioni shtet i obliguar të veprojë me parëgjegjësi me të dhënat e grumbulluara në procedurën, që janë të natyrës së besueshme, për subjekte të caktuara ekonomike dhe nuk guxon të zbulohen të dhënat pa lejen e tyre. Nëse vlerësohet si e nevojshme, për shkak të zbatimit të procedurës, Komisioni mund të kërkojë nga personat që disponojnë me të dhëna të besueshme t'i dorëzojnë një përmbajtje të shkurtër të të dhënave që nuk janë të karakterit të besueshëm ose sqarime për këto të dhëna, e nëse kështu e refuzojnë, t'i japin sqarimet dhe shkaqet për të cilat e refuzojnë të njëjtën.

Nëse Komisioni vlerëson se kërkesa për besueshmërinë e të dhënave nuk ka bazë, ndërsaq pala e interesuar nuk dëshiron që të dhënat në formë të prodhuesve ose të shkurtuar të shpallen publikisht, Komisioni mund t'i anashkalojë këto të dhëna, apo saktësinë e tyre ta kontrollojë nga burimet tjera.

Procedurën dhe mënyrën e caktimit të masave mbrojtëse në rastet e importit të rritur i rregullon Qeveria me propozim të Komisionit.

Masat e përkohshme për mbrojtjen e industrisë së vendit nga importi i rritur

Neni 38

N[rastet t[jasht[zakonshme kur me shtyrjen e marrjes t[masave nga neni 36 t[k[tij Ligji do t[shkaktohej d[m n[industrinë e vendit, që vështirë mund t[evitohet, Qeveria me propozim t[Komisionit mund t[caktoj[masa t[p[rkohshme, n[se në mënyrë preliminare konstatohet ekzistimi i d[shmive t[sigurta se me importin e rritur i [sht[shkaktuar d[m serioz ose pason rreziku nga krijimi e d[mit serioz n[industrinë e vendit.

Si masa t[p[rkohshme nga paragrafi 1 i k[tij neni, Qeveria me propozim t[Komisionit mund t[p[rcaktoj[mjete mbrojtëse doganore.

Organ kompetent për grumbullimin e mjeteve mbrojtëse doganore nga paragrafi 2 i këtij neni është Drejtoria Doganore e Republikës së Maqedonisë.

Masat e p[rkohshme nga paragrafi 1 i k[tij neni nuk mund t[zgjasin m[shum[se 200 dit[. N[k[tij periudh[kohore Komisioni [sht[i obliguar që ta zbatoj[procedur[sipas nenit 37 t[k[tij ligji.

N[se gjat[procedur[verifikohet se me importin e rritur nuk [sht[shkaktuar d[m serioz ose nuk ekziston rreziku për shkaktimin e dëmit seroz n[industrinë e vendit, mjetet e ark[tuara n[em[r t[mjeteve mbrojt[se, do t'u kthehen importuesve n[afat m[t[shkurt[r të mundshëm, nga të cil[ato jan[ark[tuar.

Koh[zgjatja e masave t[p[rkohshme do t[përlllogaritet n[koh[zgjatjen e p[rgjithshme t[masave nga neni 39 i k[tij ligji.

Zbatimi i masave për mbrojtjen e industrisë së vendit nga importi i rritur

Neni 39

Masat nga neni 36 t[k[tij Ligji do t[zbatohen vet[m p[r at[periudh[kohore e cila [sht[e nevojshme q[t[shmanget ose pengohet krijimi i d[meve serioze ose t[leht[sohet aftësimi i industrisë së vendit, e m[s[shumti kat[r vjet nga aplikimi i mas[.

Me p[rrjashtim nga paragrafi 1 i k[tij neni, koh[zgjatja e mas[mund t[vazhdohej n[se Komisioni konstaton se ato edhe m[tutje jan[t[nevojshme p[r parandalimin e shkaktimit t[d[mit serioz ose n[se industria e vendit [sht[n[procedur[adaptimi. N[k[tij rast masa nuk mund t[jet[m[e rrept[prej mas[paraprakisht t[p[rcaktuar.

Komisioni [sht[i obliguar t'i p[rcjell[efektet nga masat e paragrafit 1 t[k[tij neni, dhe sipas nevoj[t[propozoj[Qeveris[zbutjen e tyre.

Periudha e p[rgjithshme n[t[cil[n mund t[zbatohen masat nga paragrafi 1 t[k[tij neni, duke p[rfshir[edhe koh[n e masave t[p[rkohshme, nuk mund t[zgjas[m[shum[se tet[vjet nga aplikimi ose vazhdimi i masave paraprakisht t[caktuara.

Nëse pritet se masat nga neni 36 i k[tij Ligji t[zgjasin m[shum[se nj[vit, Komisioni obligohet t'i propozoj[Qeveris[q[n[intervale t[njëjta kohore t'i zbus[ato masa. N[se p[rcaktohet mas[me afat m[t[gjat[se tre vjet, Komisioni është i obligueshëm që m[s[voni n[gjysm[n e k[saj periudhe t'i konstatoj[efektet e tyre dhe t[vler[soj[a ka kushte p[r zbutjen ose abrogimin e tyre.

Neni 40

Masa mbrojtëse për mallra, për të cilat masat e tilla tashmë ishin përcaktuar, mund të përcaktohen përsëri pas skadimit të periudhës që i përgjigjet periudhës gjatë së cilës kanë zgjatur këto masa, por në asnjë rast jo më pak para skadimit të kohës para dy vitesh nga pushimi i vlefshmërisë së tyre.

Si përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, masat me kohëzgjatje prej 180 ditësh ose më pak mund të caktohen me kusht që të ketë kaluar një periudhë prej së paku një viti

nga aplikimi i masës mbrojtëse paraprake, edhe pse ajo masë nuk ka qenë e caktuar për mallin e njëjtë më shumë se dy herë, në periudhën prej dy vitesh.

Neni 41

N[rast t[aplikimit t[masave nga neni 36 t[k[tij Ligji, me k[rkes[t[vendit eksportues, Qeveria me propozim t[Komisionit mund t'i propozoj[Qeveris[s[atij vendi q[t'i lejoj[kompensim t[caktuar tregtar p[r shkak t[eliminimit t[pasojave t[d[mshme q[i ka ai vend nga aplikimi ose zgjatja e masave n[Republik[n e Maqedonis[.

Masat nga neni 36 t[k[tij Ligji, Qeveria nuk do t'i p[rcaktoj[p[r import t[mallrave me prejardhje nga vendet n[zhvillim - an[tare t[Organizat[s Bot[rore Tregtare, përdërisa pjesëmarrja e importit t[ndonjë malli t[caktuar nga k[to vende nuk tejkalon 3% e importit të p[rgjithsh[m të atij malli, me kusht q[pjesëmarrja e përbashkët e vendeve n[zhvillim - an[tare t[Organizat[s Bot[rore Tregtare, me pjes[marrje n[import nën 3%, të mos jetë m[i madh se 9% nga importi i p[rgjithsh[m i atij malli n[Republik[n e Maqedonis[.

Kufizimi sasior ose sipas vlerës

Neni 42

N[se me masat nga neni 36 t[k[tij Ligji, Qeveria me propozim t[Komisionit p[rcakton kufizim sasior ose të vlerës të importit t[mallrave t[caktuar, v[llimi i këtyre mallrave nuk guxon t[jet[m[i vogl[se importi mesatar vjetor i këtyre mallrave, të realizuara n[tre vitet e fundit, p[rvet[n[rastet kur ekziston arsyetim i qartë se nevojitet nivel tjetër fare i mbrojtjes për shkak të pengimit të krijimit t[d[mit serioz.

N[se ndarja e mallrave nga paragrafi 1 i këtij neni bëhet ndërmjet më shumë vendeve, Qeveria me propozim t[Komisionit me vendet anëtare t[Organizat[s Bot[rore Tregtare, ve[an[risht t[interesuara p[r eksportin e k[tyre mallrave n[Republik[n e Maqedonis[, mund ta harmonizoj[m[nyr[n e ndarjes t[k[tyre mallrave dhe pjesëmarrjen e tyre n[k[tij ndarje. N[se konstatohet se m[nyra e tillë e ndarjes nuk [sht[p[rcakt[se, v[llimi i përcaktuar i mallrave do t'u ndahet n[pjes[t[barabarta vendeve eksportuese n[pajtim me pjesëmarrjen e tyre në importin e p[rgjithsh[m t[malli të caktuar n[Republik[n e Maqedonis[, p[r periudh[t[caktuar, duke mbajtur me këtë rast llogari edhe p[r rrethanat tjera t[r[nd[sishme t[cilat ndikojn[ose mund t[ndikojn[n[importin e k[tyre mallrave.

Me përjashtim nga paragrafi 2 i këtij neni, Qeveria mund ta ndryshojë mënyrën e ndarjes të mallrave nga paragrafi 1 i këtij neni, nëse:

- importi nga ndonjë vend i caktuar anëtar i Organizatës Botërore Tregtare rritet në mënyrë joproporcionale në raport me rritjen e përgjithshme të importit të ndonjë malli të caktuar në atë periudhë të caktuar;
- ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për heqje dorë; dhe
- kushtet për heqje dorë janë të njëjta ndaj të gjitha vendeve anëtare të Organizatës Botërore Tregtare (furnizues) të atyre mallrave.

Kohëzgjatja e masave nga neni 36 i këtij Ligji nuk mund të jetë më e gjatë nga periudha e përcaktuar në nenin 39 të këtij Ligji, madje edhe atëherë kur ekziston rreziku nga paraqitja e dëmit serioz në industrinë e vendit.

Masa për pengimin e prishjes së bilansit pagesor

Neni 43

Nëse konstatohet se me importin e rritur të disa mallrave të caktuara, mund të krijohet çrregullim në bilansin pagesor të Republikës së Maqedonisë, Qeveria me propozim të Komisionit, mund të aplikojë masa mbrojtëse në formë të kufizimit sasior ose kufizimit të vlefshmërisë të importit të atyre mallrave.

Masat për mbrojtjen e pasurive të papërtëritshme natyrore

Neni 44

Nëse konstatohet se me eksportin e rritur të disa mallrave të caktuara, shkaktohet dëm serioz ose ekziston rreziku i shkaktimit të dëmit serioz të pasurive të

папëртëritshme natyrore të Republikës së Maqedonisë, Qeveria me propozim të Komisionit, mund të aplikojë masa mbrojtëse në formë të kufizimit sasior ose të vlerës, nëse në të njëjtën kohë me këto masa kufizohet edhe tregtia e atyre mallrave në Republikën e Maqedonisë.

Neni 45

Qeveria, me propozim të Komisionit, më për së afërmi do ta përcaktojë mënyrën dhe procedurën e realizimit të masave nga nenet 36 deri në nenin 44 të këtij ligji.

Masat kundër importit të subvencionuar

Neni 46

Qeveria, me propozim të Komisionit, mund të caktojë shpenzime kompensuese për një mall të caktuar, i cili importohet nëse:

- në prodhimin ose eksportin e atij malli lejohen subvencione në vendin e prejardhjes ose vendin e eksportit, përveç kur janë në pyetje subvencionet kundër të cilave nuk mund të ndërmerren masa nga ky nen, në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Maqedonisë;

- importi i mallit, i cili subvencionohet, shkakton dëm ose kërcënohet t'i shkaktojë dëm prodhimit të vendit ose do të mund ta ngadalësonte zhvillimin ekonomik.

Shpenzim kompensues, sipas këtij neni është shpenzimi i posaçëm që paguhet me qëllim të neutralizimit të çdo subvencionit, i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi është lejuar për përpunim, për prodhim ose për eksportin e mallit.

Import i subvencionuar, sipas këtij ligji, konsiderohet kur malli i cili importohet në Republikën e Maqedonisë është lëndë e ndihmës të drejtpërdrejtë ose të tërthortë gjatë prodhimit ose eksportit në shtetin nga i cili është malli ose nga shteti që eksportohet.

Neni 47

Kërkesa për caktimin e të dhënave kompensuese parashtrohet në emër të të gjithë prodhuesve të vendit për një mall të caktuar, apo të prodhuesve prodhimtaria e të cilëve paraqet pjesën dominante të prodhimit të përgjithshëm të atij malli.

Kërkesa, Komisionit i parashtrohet me shkrim. Nëse Komisioni konstaton se kërkesa është paraqitur nga prodhuesit e paragrafit 1 të këtij neni apo nga personi, të cilin ata e kanë autorizuar për paraqitjen e kërkesës, do të ngrejë procedurë.

Kërkesës nga paragrafi 1 të këtij neni do t'i bashkangjiten edhe dëshmitë për:

- ekzistimin e subvencioneve për një mall të caktuar dhe nëse është e mundur për shumën e tij;
- dëmin, të cilin e shkakton ky subvencion në prodhimtarinë e vendit, ashtu siç është definuar në pajtim me nenin VI nga Marrëveshja e Përgjithshme për Dogana dhe Tregti (GATT) 1994;

- lidhja shkakore ndërmjet importit të subvencionuar dhe dëmit që i shkaktohet prodhimit të vendit.

Komisioni mund të ngrejë procedurë nga paragrafi 2 i këtij neni edhe pa kërkesë me shkrim të prodhuesve të dëmtuar, nëse ekzistojnë dëshmi të mjaftueshme për importin e subvencionuar, dëmin të cilin ky import ia shkakton prodhimit të vendit dhe lidhja shkakore ndërmjet importit të subvencionuar dhe dëmit, të cilat e arsyetojnë ngritjen e procedurës.

Komisioni, pas procedurës së ngritur, do të verifikojë a janë plotësuar të gjitha kushtet për aplikimin e shpenzimeve kompensuese dhe do ta caktojë lartësinë e cila i pëgjigjet lartësisë së subvencionit. Lartësia e shpenzimeve kompensuese mund të jetë edhe më e ulët nëse është e mjaftueshme që ta evitojë dëmin e prodhimit të vendit.

Shpenzimet e kompensimit do të zbatohen deri në evitimin e dëmit të shkaktohet prodhimit të vendit. Komisioni, pas një kohe të caktuar, do ta rishqyrtojë nevojën për zbatimin e mëturshëm të dhënies së kompensimit, me iniciativë vetanake apo me kërkesë të palës së interesuar, nëse ajo e dëshmon arsyeshmërinë për rishqyrtimin e shpenzimit të kompensimit.

Procedurën dhe mënyrën e verifikimit të shpenzimit të kompensimit e përcakton Qeveria me propozim të Komisionit.

VI. MBIKËQYRJA

Neni 48

Mbikëqyrjen mbi zbatimin e k[tij Ligji dhe dispozitat e miratuara mbi baz[n e tij e bën Ministria e Ekonomisë[.

Inspektim mbikëqyr[s mbi zbatimin e dispozitave t[k[tij Ligji, bëjnë Inspektorati Shtet[ror i Tregut, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe organet tjera inspektuese dhe doganore n[pajtim me autorizimet e verifikuara me këtë ligj dhe ligjet e ve]anta.

Neni 49

N[se inspektori shtet[ror i tregut, gjat[kryerjes t[mbikëqyrjes konstaton se trgtari:

1. e kryen veprimtarinë tregtare pa u p[rmbushur kushtet e caktuara minimale-teknike, si dhe kushtet tjera të caktuara me këtë ligj varësisht nga lloji dhe mënyra e kryerjes së tregtisë (neni 22), dhe

2. nuk e mban evidencën për sigurimin dhe shitjen e mallrave me pakicë dhe shumicë, si dhe për ofrimin e shërbimeve tregtare të përcaktuara me ligj dhe dispozita të tjera (neni 28), do të marrë vendim për ndalimin e kryerjes së veprimtareisë dhe do të caktojë afat për evitimin e parregullshmërive, të verifikuara me konstatimin e inspektorit (neni 22).

Nëse edhe për herë të dytë gjatë vitit konstatohet se nuk janë përmblusur kushtet nga neni 22 i këtij ligji, organi kompetent inspektues do të marrë vendim, me të cilin tregtarit do t'i shqiptojë ndalimin e kryerjes së veprimtareisë në afat prej 180 ditësh.

Kund[r vendimit nga paragrafët 1 dhe 2 dhe 3 t[k[tij neni mund t'i paraqitet ankes[ministrit të Ekonomisë.

Ankesa e paraqitur kund[r vendimit nga paragrafët 1, 2 dhe 3 t[k[tij neni nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.

Neni 50

N[se inspektori shtet[ror i tregut gjat[kryerjes s[mbikëqyrjes konstaton se tregtari:

- 1) pa qenë i regjistruar në regjistrin përkatës në pajtim me ligjin bën tregti dhe ofron shërbime në tregti (neni 2 paragrafi 2);

- 2) bën tregti me shumicë n[tregjet me pakicë ose bën tregti me pakicë në tregjet me shumicë (neni 7);

- 3) bën tregti me shumicë para magazinave, depove dhe lokaleve afariste (neni 8 paragrafi 1);

- 4) bën tregti me pakicë dhe ofron shërbime në tregti para shitoreve, përkatësisht lokaleve afariste për të cilët nuk ka leje nga Komuna, përkatësisht qyteti i Shkupit (neni 8 paragrafi 2);

- 5) në tregjet e gjelbra dhe pjesët e organizuara posaçërisht të tregjeve të gjelbra bën tregti me shumicë dhe pakicë të mallrave të tjera, të cilat nuk janë përcaktuar nga Këshilli i Komunës, përkatësisht qyteti i Shkupit (neni 13 paragrafi 4);

- 6) tregtari i cili organizon treg, pikat p[r shitje ua jep personave t[cil[t nuk janë regjistruar, përkatësisht të evidentuar në pajtim me ligjin (neni 14 paragrafi 1);

- 7) në tregjet e organizuara posaçërisht bën tregti mallrash të cilat nuk përmenden në nenin 15 të këtij ligji;

- 8) bën tregti mallrash në qoshqe, automate dhe shitje nga shitës rrugësh në vendet që nuk janë caktuar nga Këshilli i Komunës, përkatësisht nga qyteti i Shkupit (neni 16 paragrafi 3);

- 9) nuk e publikon vendin dhe kohën e kryerjes të shitjes publike dhe në ankand (neni 17 paragrafi 2);

- 10) nuk u përmbahet kushteve për shitje publike dhe në ankand në pajtim me nenin 17 paragrafi 4 i këtij ligji;

- 11) kryerësi i tregtisë nga dera në derë bën shitje të prodhimeve që nuk janë përcaktuar nga Qeveria (neni 20 paragrafi 2) dhe nuk ka dorëzuar evidencën e shitësve nga dera në derë në organin kompetent për të hyra publike në rajonin e Komunës, përkatësisht qytetit të Shkupit (neni 20 paragrafi 4);

12) lëshon në qarkullim mallra që nuk u përgjigjen cilësive fizike-kimike dhe organike, nuk janë të paketuara, të deklaruara, shënuara, përkatësisht të shënuara në pajtim me ligjin (neni 21 paragrafi 1);

13) mallrat nuk përputhen me kërkesat e caktuara teknike, të përcjella me dokumente të përcaktuara në dispozitat teknike me servis të siguruar, pjesë ndërrimi, pa të cilat prodhimet nuk mund të shfrytëzohen për destinimin e tyre (neni 21 paragrafi 2);

14) u shet pije alkoolike dhe cigare personave me moshë nën 18 vjeç (neni 24 paragrafi 1);

15) fillon punën në ndërtesën kolektive të banimit dhe ndërtesën afariste banesore para orës 06:00 dhe nuk e përfundon para orës 24:00 (neni 25 paragrafi 2);

16) të dielave dhe festat shtetërore punon pas orës 17:00 (neni 25 paragrafi 3);

17) nuk mban evidencë për furnizimin dhe shitjen e mallrave, si dhe për dhënien e shërbimeve tregtare në pajtim me ligjin (neni 28 paragrafi 1);

18) nuk i përmbahet masave (neni 30 paragrafi 2); dhe

19) bën import pa leje të mallrave të përcaktuara në nenin 34 të këtij ligji, do të marrë vendim për kryerjen e veprimtarisë dhe do të caktojë afat për evitimin e parregullshmërive, të verifikuara me konstatimin e inspektorit, në pajtim me ligjin.

Nëse në afatin e caktuar nuk evitohen parregullshmëritë e konstatuara, inspektori do të marrë vendim për ndalimin e kryerjes të veprimtarisë në kohëzgjatje prej 90 ditësh.

Në rastet nga paragrafi 1 pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 12, 13, 18 dhe 19, inspektori shtetëror i Tregut përkohësisht do t'i marrë sendet – mallrat me të cilët bëhet tregtia.

Për marrjen e sendeve – mallrave nga paragrafi 3 i këtij neni, inspektori Shtetëror i Tregut lëshon vërtetim.

Për sendet – mallrat që i nënshtrohen prishjes, inspektori Shtetëror i Tregut ndërmerr veprime për shitjen e tyre, ndërsa paratë nga shitja i derdh në llogari të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

Kundër vendimit nga paragrafi 1 i k[tij neni mund t'i paraqitet ankesë ministrit të Ekonomisë.

Ankesa e paraqitur kundër vendimit nga paragrafi 1 i k[tij neni nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.

Neni 51

N[se tregtari nuk e lajmëron përmbushjen e kushteve nga neni 22 i këtij ligji dhe fillimin me punë të objektit shitës dhe afarist, në pajtim me nenin 23 të këtij ligji, Inspektori Shtetëror i Tregut do të marrë vendim për ndalimin e kryerjes të veprimtarisë dhe do të caktojë afat për paraqitjen e përmbushjes të kushteve nga neni 22 të këtij ligji.

Nëse në afatin e caktuar tregtari nuk i eviton parregullshmëritë, inspektori do të marrë vendim për ndalimin e kryerjes së veprimtarisë në afat prej 90 ditësh.

Kundër vendimit nga paragrafët 1 dhe 2 t[k[tij neni mund t'i paraqitet ankesë ministrit të Ekonomisë.

Ankesa e paraqitur kundër vendimit nga paragrafi 1 dhe 2 t[k[tij neni nuk e shtyn ekzekutimin e tij.

Neni 52

N[se tregtari caktimin e kohës së punës nuk e harmonizon me numrin e të punësuarve në shitore, magazina, depo, stacione të benzinës dhe lokale afariste dhe të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre nga marrëdhënia e punës, të përcaktuara me ligjin me të cilin rregullohen marrëdhëniet e punës, sidomos sa i përket caktimit të kohës së punës dhe punës jashtë orarit, punës së natës, pushimeve dhe pushimit vjetor dhe mungesave tjera nga puna dhe në pajtim me kufizimet e përcaktuara me dispozitat nga lëmi i mbrojtjes nga zhurma, sipas nenit 25 të këtij ligji, Inspektori Shtetëror i Punës, me vendim, do t'i caktojë afat në të cilin tregtari është i obliguar ta harmonizojë kohën e punës sipas nenit 25 paragrafi 2 i këtij ligji.

Nëse në afatin e caktuar tregtari nuk i eviton parregullshmëritë e konstatuara, Inspektori Shtetëror i Punës, do të marrë vendim për ndalimin e kryerjes së veprimtarisë, në kohëzgjatje prej 90 ditësh.

Nëse për herë të dytë gjatë vitit konstatohet se tregtari nuk i përmbahet vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni, inspektori Shtetëror i Punës, me vendim, do t'ia ndalojë kryerjen e tregtisë, në kohëzgjatje prej 180 ditësh.

Kundër vendimit nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni mund t'i paraqitet ankesë ministrit të Punës dhe Politikës Sociale.

Ankesa e paraqitur kundër vendimit nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni nuk e shtyn ekzekutimin e tij.

Neni 53

N[se tregtari importon ose eksporton mallra pa leje sipas nenit 34 të këtij ligji, inspektori Shtetëror i Tregut përkohësisht do t'i marrë sendet – mallrat, deri në marrjen e vendimit nga gjyqi kompetent.

Për marrjen e mallrave nga paragrafi 1 i këtij neni inspektori Shtetëror i Tregut lëshon vërtetim.

Për mallrat që i nënshtrohen prishjes, inspektori Shtetëror i Tregut ndërmerr veprime për shitjen e tyre, ndërsa paratë nga shitja i derdh në llogari të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

Neni 54

Nëse inspektori Shtetëror i Tregut gjatë mbikëqyrjes konstaton se tregtari:

1. nuk e vendos orarin e tregut dhe të kohës së punës dhe nuk i përmbahet orarit të tregut dhe të kohës së punës (neni 14 paragrafi 3);

2. në vend të dukshëm në objektin shitës nuk e vë mbishkrimin sipas nenit 24 paragrafi 2 i këtij ligji;

3. evidenca nuk gjendet në lokalin përkatës afarist, përkatësisht në lokalin përkatës afarist në të cilin bëhet tregtia dhe në çdo kohë nuk ka qasje për organet kompetente inspektuese (neni 28 paragrafi 2), me vendim do të urdhërojë të evitohen mangësitë e konstatuara në afat të caktuar.

Nëse në afatin e caktuar tregtari nuk i eviton parregullshmëritë e konstatuara, inspektori Shtetëror i Tregut do të marrë vendim për ndalimin e kryerjes të veprimtarisë, në kohëzgjatje prej 90 ditësh.

Kundër vendimit nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni mund t'i paraqitet ankesë ministrit të Ekonomisë.

Ankesa e paraqitur kundër vendimit nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni nuk e shtyn ekzekutimin e tij.

VII. DISPOZITA ND{SHKUESE

Neni 55

Me dënim në para prej 200.000 denar[do t[nd[shkohet p[r kund[rvajtje personi juridik, n[se:

1) kryen tregti pa qenë i regjistruar në regjistrin përkatës në pajtim me ligjin (neni 2 paragrafi 2);

2) kryen tregti me shumic[në tregjet me pakicë ose kryen tregti me pakic[në tregjet me shumicë (neni 7);

3) u shet pije alkoolike dhe cigare personave me moshë nën 18 vjeç (neni 24 paragrafi 1);

4) nuk mban evidenc[p[r sigurimin dhe shitjen e mallrave me shumic[dhe pakic[, gjegj[sisht p[r ofrimin e sh[rbimeve (neni 28 paragrafi 1);

5) evidenca të cilën e mban nuk gjendet në lokalin përkatës afarist në të cilin bëhet tregtia dhe në çdo kohë nuk ka qasje për organet kompetente inspektuese (neni 28 paragrafi 2);

6) nuk u përmbahet masave të caktuara (neni 30 paragrafi 2);

7) kryen eksport dhe import të mallrave pa leje në pajtim me nenin 34 të këtij ligji.

P[r veprimet nga paragrafi 1 t[k[tij neni, përveç dënimit në para, personit juridik do t'i shqiptohet edhe masa e sigurisë ndalim i kryerjes të tregtisë në kohëzgjatje prej 2 deri 4 vjet.

Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni do t'i shqiptohet dënim p[r kund[rvajtje prej 20.000 deri 50.000 denarë edhe për personin përgjegjës në personin juridik.

Për veprimet nga paragrafi 1 pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të këtij neni, personit juridik do t'i shqiptohet edhe masa e sigurisë marrja e sendeve – mallrave të marrura përkohësisht.

P[er veprimet nga paragrafi 1 t[k[tij neni, përveç dënimit në para, personit përgjegjës në personin juridik do t'i shqiptohet masa e sigurisë ndalim i detyrës përgjegjëse, në kohëzgjatje prej tre muajsh deri n[nj[vit.

Neni 56

Me dënim në para prej 150.000 deri 250.000 denarë do të dënohet për kundërvajtje personi juridik nëse:

1) bën tregti me shumicë para magazinave, depove dhe lokaleve afariste (neni 8 paragrafi 1);

2) bën tregti me pakicë dhe ofrim të shërbimeve në tregti para shitoreve, përkatësisht lokaleve afariste, për çka kjo nuk është lejuar nga Këshilli i Komunës, përkatësisht nga qyteti i Shkupit (neni 8 paragrafi 2);

3) në tregjet e gjelbra dhe pjesët posaçërisht të organizuara në tregjet e gjelbra bën tregti me shumicë dhe pakicë të mallrave të tjera, që nuk janë caktuar nga Këshilli i Komunës, përkatësisht qyteti i Shkupit (neni 13 paragrafi 4);

4) në tregjet e gjelbra të organizuara, ku bëhet tregtia me shumicë dhe pakicë, vendet e shitjeve ua jep personave që nuk janë të regjistruar në regjistrin përkatës, përkatësisht të evidentuar në pajtim me ligjin (neni 14 paragrafi 1);

5) në tregjet e organizuara posaçërisht bën tregti me mallra, të cilat nuk përmenden në nenin 15 të këtij ligji;

6) nuk u përmbahet kushteve të caktuara për kryerjen e shitjes publike dhe me aukcion (neni 17 paragrafi 4);

7) kryen tregti me shumicë dhe pakicë, prej dere në derë, pa lidhë marrëveshje me konsumatorin (neni 20 paragrafi 1);

8) lëshon në qarkullim mallra që nuk u përgjigjen cilësive fizike-kimike dhe organike, nuk janë të paketuara, të deklaruar, të shënuara, përkatësisht të shënuara në pajtim me ligjin (neni 21 paragrafi 1);

9) mallrat nuk janë caktuar me kërkesat teknike, të përcjellura me dokumente, të përcaktuara me dispozitat teknike, me servis të siguruar, pjesë ndërrimi, pa të cilat prodhimet nuk mund të shfrytëzohen për destinimet e tyre (neni 21 paragrafi 2);

10) nuk i përmbush kushtet e caktuara minimale teknike dhe kushtet e tjera të caktuara me ligj, varësisht nga lloji dhe mënyra e kryerjes së tregtisë (neni 22 paragrafi 1);

11) nuk u përmbahet dispozitave 1 dhe 2 të nenit 25 të këtij ligji, dhe

12) nuk ia paraqet orën dhe orarin e punës Komunës, përkatësisht qytetit të Shkupit dhe inspektorit Shtetëror të Punës së paku 15 ditë para fillimit të punës, përkatësisht para ndërrimit të orës dhe orarit të punës në shitore, magazina, depo, stacionet e benzinës dhe lokalet afariste (neni 26 paragrafi 2).

P[er veprimet nga paragrafi 1 t[k[tij neni përveç dënimit në para për veprime nga paragrafi 1 të këtij neni, personit juridik do t'i shqiptohet edhe masa ndalim i kryerjes së veprimtarisë në kohëzgjatje prej 1 deri në tre vjet.

Për veprimet nga paragrafi 1 të këtij neni do t'i shqiptohet dënim për kundërvajtje prej 20.000 deri 50.000 denarë edhe personit përgjegjës në personin juridik.

Për veprimet nga paragrafi 1 pikat 1, 2, 3, 4, 5, 8 dhe 9 të këtij neni, personit juridik do t'i shqiptohet masa e sigurisë marrja e sendeve – mallrave të marrura përkohësisht.

Për veprimet nga paragrafi 1 të këtij neni përveç dënimit në para, personit përgjegjës në personin juridik do t'i shqiptohet masa e sigurisë ndalim i kryerjes të detyrës përgjegjësi, në kohëzgjatje prej tre muajsh deri në një vit.

Neni 57

Me dënim në para prej 50.000 deri 150.000 denarë do të dënohet personi juridik nëse:

1) nuk përcakton dhe nuk vendos orarin e tregut dhe të kohës së punës në tregjet e gjelbra dhe nuk i përmbahet orarit të tregut dhe kohës së punës (neni 14 paragrafi 3);

2) bën tregti mallrash në qoshqe, automate dhe tregti të shitësve lëvizës në rrugë, në vendet që nuk janë përcaktuar me vendim të Këshillit të Komunës, përkatësisht të qytetit të Shkupit (neni 16 paragrafi 2);

3) nuk e publikon vendin dhe kohën e kryerjes të shitjes publike dhe në ankand (neni 17 paragrafi 2);

4) bën tregti prej dere në derë, të prodhimeve që nuk janë përcaktuar nga Qeveria (neni 20 paragrafi 2);

5) kryerësi i tregtisë, prej dere në derë, nuk ka legjitimacion identifikues (neni 20 paragrafi 4);

6) nuk e dorëzon evidencën e shitësve prej dere në derë në organin kompetent të Drejtorisë të të Hyrave Publike të Komunës, përkatësisht të qytetit të Shkupit (neni 20 paragrafi 5);

7) nuk e paraqet përmbushjen e kushteve nga neni 22 të këtij ligji dhe fillimin me punë të Inspektoratit Shtetëror të Tregut dhe të organit kompetent të Komunës, përkatësisht të qytetit të Shkupit, së paku 15 ditë para fillimit të punës në objektin e shitjes ose në objektin tjetër afarist (neni 23 paragrafi 1);

8) në vend të dukshëm në objektin e shitjes nuk e vë mbishkrimin me madhësi 20X50 cm me përmbajtjen: "Ndalohejt shitja e pijeve alkoolike dhe cigareve për personat me moshë nën 18 vjeç" (neni 24 paragrafi 2);

9) shitoret që gjenden në ndërtesë kolektive të banimit dhe në ndërtesë afariste-banesore të fillojnë punën prej orës 06:00 dhe të mos e përfundojnë punën deri në orën 24:00 (neni 25 paragrafi 3);

10) shitoret, të dielave dhe gjatë festave shtetërore punojnë pas orës 17:00 (neni 25 paragrafi 4);

11) në rast të arsyeve objektive e ndërpret punën ose e ndryshon orarin e punës sipas nenit 26 paragrafi 3 të këtij ligji, nuk e njofton për arsyet Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe organin kompetent të Komunës, përkatësisht qytetin e Shkupit në afat prej 5 ditësh nga dita e ndërprerjes së punës (neni 26 paragrafi 4), dhe

12) nuk e thekson orarin e punës dhe numrin e telefonit të Inspektoratit Shtetëror të Tregut të atij rajoni në vend të dukshëm në hyrje të shitoreve, magazinave, depove, stacioneve të benzinës dhe lokalet afariste dhe nuk i përmbahet orarit të theksuar të punës (neni 27).

Për veprimet nga paragrafi 1 pika 2 e këtij neni personit juridik do t'i shqiptohet masa e sigurisë marrje e sendeve – mallrave të marrura përkohësisht.

Për veprimet nga paragrafi 1 të këtij neni do të dënohet për kundërvajtje prej 10.000 deri 50.000 denarë edhe personi përgjegjës në personin juridik.

Për veprimet nga paragrafi 1 të këtij neni, inspektori Shtetëror i Tregut në vend të ngjarjes mund ta dënojë me 15.000 denarë personin juridik, ndërsa personin përgjegjës në personin juridik 7.000 denarë.

Neni 58

Me dënim në para prej 30.000 deri 50.000 do të dënohet për kundërvajtje personi fizik i cili bën tregti për veprimet nga nenet 55 paragrafi 1, 56 paragrafi 1 dhe 57 paragrafi 1 të këtij ligji.

Për veprimet nga neni 55 paragrafi 1, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të këtij ligji dhe neni 56 paragrafi 1 pikat 1, 2, 3, 4, 5, 8 dhe 9 të këtij ligji do të shqiptohet masa e sigurisë marrja e sendeve – mallrave të marrura përkohësisht.

Për kundërvajtjen nga neni 56 paragrafi 1 i këtij ligji, Inspektori Shtetëror i Tregut mund të shqiptojë dënim në para në vend të ngjarjes prej 5.000 denarë për personin fizik që bën tregti.

Neni 59

Për kundërvajtjen e paraparë në nenin 55 paragrafin 1 pika 1 të këtij ligji, nëse është bërë nga persona me moshë nën 18 vjeç do të dënohet prindi, përkatësisht kujdestari me dënim në para prej 2.000 deri 5.000 denarë.

Për veprimet nga paragrafi 1 të këtij neni, përveç dënimit në para për prindin, përkatësisht kujdestarin, do të shqiptohet edhe masa e sigurisë marrja e sendeve – mallrave të marrura përkohësisht.

VIII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 60

Zbatimi i nenit 23 paragrafi 1 i këtij ligji nuk ka të bëjë me tregtarin i cili ka filluar me kryerjen e tregtisë para ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 61

Tregtari, i cili ka organizuar tregje me shumicë dhe pakicë është i obliguar ta harmonizojë punën e tregut në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 62

Tregtari është i obliguar që në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji ta harmonizojë punën e vet me dispozitat e nenit 32 paragrafi 1, alineja 3 e këtij ligji.

Neni 63

Komisionin nga neni 35 të këtij ligji Qeveria do ta emërojë në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Dispozitat nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 3 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Deri në miratimin e dispozitave nga paragrafi 2 i këtij neni do të zbatohen dispozitat ekzistuese.

Neni 64

Procedurat që kanë filluar, por që nuk kanë përfunduar deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, do të përfundojnë sipas dispozitave që kanë vlejtur deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Neni 65

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të vazhdojnë të zbatohen dispozitat nga neni 57a, 57b dhe 57g të Ligjit për punën e jashtme tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 31/93, 41/93, 78/93, 59/96, 15/97, 13/98, 13/99, 50/99, 82/99, 4/2001, 2/2002, 45/2002 dhe 31/2003)

Dispozitat nga paragrafi 1 i këtij neni do të zbatohen deri më 31.12.2005.

Neni 66

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji pushon të vlejë Ligji për tregtinë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 23/95, 30/95, 43/95, 23/99, 43/99, 6/2002 dhe 38/2003), përveç nenit 24 i cili do të zbatohet një vit nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe Ligjit për punën e jashtme tregtare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 45/2002 dhe 31/2003).

Neni 67

Ky Ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

280.

Врз основа на член 75 ставови 1 и 2 и член 82 став 1 од Уставот на Република Македонија, вршителот на функцијата претседател на Република Македонија и претседател на Собранието на Република Македонија, издава

У К А З

ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ЛИЧНАТА КАРТА

Се прогласува Законот за изменување и дополнување на Законот за личната карта, што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 12 март 2004 година.

Бр. 07-1149/1
12 март 2004 година
Скопје

Вршител на функцијата
Претседател
на Република Македонија,
Претседателот
на Собранието на Република
Македонија,
д-р Љупчо Јордановски, с.р.

Претседател
на Собранието на Република
Македонија,
д-р Љупчо Јордановски, с.р.

ЗАКОН ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ЛИЧНАТА КАРТА

Член 1

Во Законот за личната карта ("Службен весник на Република Македонија" број 8/95 и 38/2002), во членот 1 став 1 сврзникот "и" се заменува со записка, а по зборот "живеалиштето" се додаваат зборовите: "и престојувалиштето".

По ставот 1 се додава нов став 2, кој гласи:

"Личната карта може да се употребува и за преминување на државната граница, во случаи и под услови утврдени со меѓународен договор ратификуван согласно со Уставот на Република Македонија."

Ставот 2 станува став 3.

Член 2

Во членот 4 став 1 зборот "се" се заменува со зборовите: "граѓанинот лично го".

Ставот 3 се менува и гласи:

"Со барањето од ставот 2 на овој член по исклучок, граѓаните родени во странство поднесуваат и извод од матичната книга на родените."

Член 3

Во членот 5 став 2 по зборовите: "живеалиште и адреса на станот," се додаваат зборовите: "престојувалиште и адреса на станот".

Во ставот 3 зборот "латинично" се брише.

Во ставот 4 зборовите: ", а податоците за името и презимето на граѓанинот, полот и државјанството се запишуваат и на англиски јазик и неговото латинично писмо" се заменуваат со зборовите: "и на основно латинско писмо (ICAO Doc 9303)".

Во ставот 5 зборовите: "и податоците во него се запишуваат" се бришат.

По ставот 5 се додава нов став 6, кој гласи:

"На граѓаните кои зборуваат јазик различен од македонскиот јазик и јазикот што го зборуваат најмалку 20% од граѓаните, образецот на личната карта се печати и на јазикот и писмото што го употребува граѓанинот."

Член 4

Во членот 7 ставот 1 се менува и гласи:

"Личната карта се издава со рок на важење од десет години, а за граѓанин помлад од 27 години живот со рок на важење од пет години."

По ставот 1 се додава нов став 2, кој гласи:

"На граѓанинот кој најмалку два пати ќе загуби лична карта или на друг начин ќе остане без неа, заменетата лична карта му се издава со рок на важење од една година. По истекот на овој рок, новата лична карта се издава со рок на важење утврден во ставот 1 на овој член."

Ставот 2 станува став 3.

Член 5

По членот 7 се додаваат три нови члена 7-а, 7-б и 7-в, кои гласат:

"Член 7-а

Министерството за внатрешни работи на барање на надлежниот суд, кој под услови и на начин утврдени со Законот за патните исправи на државјаните на Република Македонија може да бара одбивање на барањето за издавање на пасош, односно одземање на пасошот, со решение ќе забрани употреба на личната карта за преминување на државната граница.

Против решението од ставот 1 на овој член жалба може да се поднесе до надлежната комисија на Владата на Република Македонија.

Жалбата од ставот 2 на овој член не го одлага извршувањето на решението.

Член 7-б

За сите факти кои за последица имаат престанување на причините за забрана на употреба на личната карта за преминување на државната граница, надлежниот суд веднаш по службена должност го известува Министерството за внатрешни работи.

Ќе се смета дека се престанати причините за забрана на употреба на личната карта за преминување на државната граница, ако надлежниот суд не го обнови барањето по истекот на една година од денот на поднесувањето на барањето.

Во случаите од ставовите 1 и 2 на овој член, на барање на граѓанинот, Министерството за внатрешни работи ќе ја избрише забраната за употреба на личната карта за преминување на државната граница.

Член 7-в

Министерот за внатрешни работи ќе го пропише начинот на забележувањето и бришењето на забраната за употреба на личната карта за преминување на државната граница, како и начинот на водење на евиденцијата од членот 14 на овој закон."

Член 6

Во членот 11 став 1 по зборот "работи" се става записка и се додаваат зборовите: "да ја огласи за неважечка во "Службен весник на Република Македонија" на свој трошок".

Член 7

По членот 11 се додава нов член 11-а, кој гласи:

"Член 11-а

Граѓанинот на кој државјанството на Република Македонија му престанало со отпуст согласно со Законот за државјанството на Република Македонија, должен е на денот на врачување на решението за отпуст од државјанството на Република Македонија личната карта да ја предаде на Министерството за внатрешни работи или ако живее во странство, на дипломатско-конзуларното претставништво на Република Македонија во странство."

Член 8

Во членот 14 по ставот 1 се додава нов став 2, кој гласи:

"Министерството за внатрешни работи води евиденција за запишувањето на забраната и за бришењето на забраната на употреба на личната карта за преминување на државната граница."

Член 9

Во членот 15 став 1 зборовите: "од една шестина до една половина од плата" се заменуваат со зборовите: "од 1.500 до 5.000 денари".

Во точката 5 по зборовите: "(член 8 став 2)" се става точка и записка, а сврзникот "и" се брише.

Во точката 6 по зборовите: "(член 9 став 2)" точката се заменува со сврзникот "и" и се додава нова точка 7, која гласи:

"7. нема да ја предаде личната карта на Министерството за внатрешни работи, односно на дипломатско-конзуларното претставништво на Република Македонија во странство (член 11-а)".

Во ставот 2 зборовите: "до една петина од плата" се заменуваат со зборовите: "до 2.000 денари".

Член 10

Во членот 17 став 1 зборот "две" се заменува со зборот "три".

Член 11

Подзаконскиот пропис чие донесување е утврдено со овој закон ќе се донесе најдоцна во рок од шест месеци од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 12

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во "Службен весник на Република Македонија".

L I G J I PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR LETËRNJOFTIM

Neni 1

Në Ligjin për letërnjoftim ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 8/95 dhe 38/2002), në nenin 1 paragrafi 1, lidhëza "dhe" zëvendësohet me presje, kurse pas fjalës "vendbanimi" shtohen fjalët: "edhe vendqëndrimi".

Pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri 2, si vijon:
"Letërnjoftimi mund të përdoret edhe për kalimin e kufirit shtetëror, në raste dhe nën kushte të përcaktuara me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë".

Paragrafi 2 bëhet paragraf 3.

Neni 2

Në nenin 4 paragrafi 1 fjala "dorëzohet" zëvendësohet me fjalët: "qytetari personalisht e dorëzon".

Paragrafi 3 ndryshon si vijon:

"Me kërkesën nga paragrafi 2 të këtij neni me përjashtim, qytetarët e lindur jashtë vendit paraqesin edhe certifikatë nga libri amë i të lindurve".

Neni 3

Në nenin 5 paragrafi 2 pas fjalëve: "vendbanimi dhe adresa e banesës;" shtohen fjalët: "vendqëndrimi dhe adresa e banesës".

Në paragrafin 3, fjala "latin" fshihet.

Në paragrafin 4 fjalët: "ndërsa të dhënat për emrin dhe mbiemrin e qytetarit, gjinia dhe shtetësia shkruhen edhe në gjuhën angleze dhe alfabetin e saj latin", zëvendësohen me fjalët: "edhe në alfabetin bazë latin (ICAO Doc 9303)".

Në paragrafin 5 fjalët: "dhe të dhënat në të shkruhen" fshihen.

Pas paragrafit 5 shtohet paragraf i ri 6, si vijon:

"Qytetarëve, të cilët flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase dhe në gjuhën që e flasin së paku 20 % e qytetarëve, formulari i letërnjoftimit shtypet edhe në gjuhën që e përdor qytetari".

Neni 4

Në nenin 7, paragrafi 1 ndryshon si vijon:

"Letërnjoftimi lëshohet me afat vlefshmërie prej dhjetë vjetësh, ndërsa për qytetar me moshë më të re se 27 vjet me afat vlefshmërie prej pesë vjetësh."

Pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri 2, si vijon:

"Qytetarit të cilit së paku dy herë do ta humbasë letërnjoftimin ose në mënyrë tjetër do të ngelë pa të, letërnjoftimi i zëvendësuar i lëshohet në afat vlefshmërie prej një viti. Pas skadimit të këtij afati, letërnjoftimi i ri i lëshohet në afat vlefshmërie të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni."

Paragrafi 2 bëhet paragraf 3.

Neni 5

Pas nenit 7 shtohen tri nene të reja 7-a, 7-b dhe 7-c, si vijojnë:

"Neni 7-a

